

Durrës më 10/06/2021

STATUTI

SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUARA

GLOBAL GRAFIKA sh.p.k

Z.David Likmeta, i datelindjes 17/10/1978, shtetas/e Shqiptar/e identifikuar me pasaporte ose karte identiteti H81017103R madhore, me zotesi juridike për të vepruar.

Z.Jonuz Myshketa, i datelindjes 29/04/1980, shtetas/e Shqiptar/e identifikuar me pasaporte ose karte identiteti I00429075B madhore, me zotesi juridike për të vepruar.

Me vullnet të plotë e të sinqertë, mbështetur:

Në Kushtetuten e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi,

Në ligjin 9901 datë 14.04.2008, “ Per Tregëtarët dhe Shoqërите Tregëtare ,

Në ligjin “Për Qëndrën Kombëtare të Rregjistrimit” në atë Doganore , Fiskal e Tatimor , ka riformular Shoqerinë tregëtare me pernjegjësi te kufizuara me emrin **“GLOBAL GRAFIKA sh.p.k”**, (më poshte e quajtur “shoqëria)

KREU 1

NENI 1

Krijimi

Shoqëria : **GLOBAL GRAFIKA sh.p.k** është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me pernjegjësi të kufizuar.

NENI 2

Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi te jete regjistruar ne QKB, ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj, Shoqeria **“GLOBAL GRAFIKA” shpk**, Pasi te kete fituar personalitetin juridik, eshte pernjegjese ndaj te tretëve detyrimet dhe demet e shkaktuara gjate veprimtarise se saj, për të cilat përgjigjet brënda kufijve të përcaktuar në Ligjin 9901 datë 14.04.2008 si dhe akte të tjera ligjore.

NENI 3

Selia

Shoqeria e ka seline ne: Lagjia 3, Rruga "Grigor Durrsaku", Pallati EGT TOWER, Kati 0. Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filial, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise. Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj sipas vullnetit te Asamblese se Ortakeve.

NENI 4

Objekti i veprimtarisë

Prodhimin e te gjitha llojeve te tabelave ndriçuese(led) dhe jo ndricuese, tabela me alukobond, punime plexiglasi, germa 3D, reklama ne seri, reklama elektronike, printime dhe brandim fasadash te brendshme dhe te jashtme, brandim automjetesh, skenografi, stenda dhe artikuj promocioni, tabela sinjalistike, etj, materialeve dhe pajisjeve për realizimin e produkteve te mësipërme, dhe tregtimin e tyre. Prodhimin e artikujve te ndryshëm promocional, si stilolapsa, çakmak, bluza, kapele, dhe artikuj te tjerë te kësaj natyre. Shërbime te ndryshme marketingu, si dizajni i websait, printime te ndryshme, si kartëvizita, fletëpalosje, banera, organizim eventesh panairi, letra murale te personalizuara, artikuj te ndryshëm kancelarie për zyra, shkolla, institucione etj. Dhe aktivitete te tjera te lidhura me to qe lejohen me ligj.

NENI 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvilloj aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papërcaktuar, duke filluar nga data e regjistimit ne QKB .

KREU 2

NENI 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 10.000 (dhjete mijë) leke, i ndare ne dy kuota.

Kapitali themeltar i shoqërisë, është kontribut i 2 (dy) Ortakeve te shoqërisë, me kuota si me poshtë:

1. Ortaku themelues David Likmeta zotëruesi i 1 (një)kuote me vlerë te përgjithshme 5.000 (pese mijë) leke ne para qe përben edhe 50% te kapitalit themelta te shoqërisë ,
2. Ortaku themelues Jonuz Myshketa zotëruesi i 1 (një)kuote me vlerë te përgjithshme 5.000 (pese mijë) leke ne natyre qe përben edhe 50% te kapitalit themalta te shoqërisë.

NENI 7 **Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimit të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë , dhe në shërbime,nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute në natyrë sipas kërkesës së administratorit .

Zvogëlimi i kapitalit realizohet me vendimin e Ortakeve themelues të shoqërisë në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Projekti i zvogelimit të kapitalit u komunikohet ekspertëve kontabël të autorizuar, në rast se ka të tillë të paktën 45 ditë përpara datës së mbledhjes së Asamblesë së Ortakeve të thirrur për të marrë vendim rreth ketij projekti .


Zvogëlimi i kapitalit themeltar në një vlerë më të vogël se ajo e përcaktuar ne nenin 6 të këtij statute ,e bën të detyrushëm marrjen e një vendimi prej shoqërisë për zmadhimin e kapitalit themeltar të paktën deri në vlerën minimale .Në rast mosbatimi të kërkeshave të këtij paragrafi , cdo person i interesuar mund të kërkoj në rrugë gjyqësore prishjen e shoqërise . Kjo prishje nuk mund të shpallet , në qoftë se rregullimi është bërë në ditën kur gjykata mblidhet për të marr vendimin .

NENI 8 **Transferimi kapitalit**

Kuota e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo të kalohen nëpërmjet :

- a) Kontributi në kapitalin e shoqërisë ,
- b) Shitblerjes,
- c) Trashëgimisë ,
- d) Dhurimit,
- e) Cdo mënyrë tjetër të parashikimit në ligj ,

Në rastin e kalimit me kontratë , kontrata duhet të behet me shkrim .Personi që kalon kuotën dhe personi qe e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare , ndaj shoqërise për kalimin e saj në Qendren Kombetare të Rregjistrimit , sipas nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 ”Për Qendren Kombetare të Rregjistrimit”.Rregjistrimi kalimit te kuotave ka efekt deklarativ .



Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie .

KREU II

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

NENI 9

Organi Vendimmarrës

Organet drejtuese te Shoqerise "GLOBAL GRAFIKA" shpk jane:

1. Asmableja e Pergjitheshme.
2. Administratori I Pergjithshem I shoqerise do te jete Z. David Likmeta per nje periudhe 5(pese) vjecare.

Asmableja e Pergjitheshme është përgjegjës për marrjen e vendimeve për shoqerinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënët e të cilët nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përvèç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

NENI 10

Administrimi



Administratori i shoqërisë caktohet brenda ortakërisë .Administrator i shoqerise caktohet **Z. David Likmeta**, e cila emërohet për një afat 5 vjecar me të drejtë përtëritje .

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim te Ortakut të vetëm themelues të shoqërisë .

NENI 11

Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të :

- a) Kryeje të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë , duke zbatuar politikat tregetare , të vendosura nga asambleja e përgjithëshme;
- b) Perfaqësoj shoqérinë tregtare ;
- c) Kujdeset për mbajtjen saktë e të rregullt të dokumentave dhe librave kontabel të shoqërisë ;
- d) Përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor , bilancin e konsoliduar dhe reportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shperndarjen e fitimeve , I paraqesin këto dokumenta përpara asamblessë së përgjithëshme për miratim;
- e) Krijojë një system paraljmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe egzistences së shoqerisë
- f) Kryejë rregjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë , sic parashikohet ne ligjin për Qendren Kombetare të Rregjistrimit.
- g) Raportoj përpara asamblessë së përgjithëshme në lidhje me zbatimin e politikave tregetare dhe me realizimin e veprimeve të posacme me rëndësi të vecantë per veprimtarinë e shoqërisë tregetare ;

Administratoret janë të detyruar të thërrasin mbledhjen e ortakëvë ne rastet kur :

Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetvë financiare , rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk I mbulojnë detyrimet e kërkueshme Brenda 3 muajve ne vazhdim dhe kur shoqëria Brenda 2 vitet e para pas rregjistrimit të saj , propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerën 5 % të aseteve të shoqërisë , që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara ,

Administratoret kanë të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm . Administratorët përfaqësojnë shoqérinë përpara të gjithë personave fizikë dhë juridik, Publike dhe / ose private venas ose të huaja , autoritetet e Shqipëtare ose te huaja,përfshi këtu marthënie me të tretët në emër të shoqërisë , në të gjitha rrethanat me përjashtim të

kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqerisë. Administratorët angazon shoqerinë në marrdhënie me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj .

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët I dinin që akti I administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna , duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme .

NENI 12

Përgjegjësitë

Administratorët janë përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve , për shkeljen e ligjeve,për shkeljen e statutit,apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë .

Pasojat e marreveshjeve të pamiratuara nga Ortaku që i sjellin dëm shoqërisë , i ngarkohen administratorit ose subjektit që ka bërë marrveshjen , për të përballuar ne menyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatësë

Përvec sa është parashikuar në dispozitat e përgjithëshme të detyrimit të besnikërisë , sipas neneve 14,15,17e 18 të ligjit “Per Tregëtarët dhe Shoqërите tregëtarë” administrator detyrohet:

- a) Të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në intersin e më të mirë të shoqërisë në tërësi , duke i kushtuar vëmëndje të vecantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis ;
- b) Të ushtrojë kompetencat që i njihen me ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) Të vlerësoj me përgjegjesi ceshtjet , për të cilat merret vendim;
- d) Të parandalojë dhe mënjanoj rastet e konfliktit , present apo të mundshëm , të interesave personal me ata të shoqerisë;
- e) Të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshem .
- f) Administrator , gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për cdo veprim ose mosveprim , që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregëtarë me përjashtim të rasteve kur në bazë të hetimit dhe vleresimit të informacioneve përkatëse veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim .
- h) Nëse administratori vepron në kundëshim me detyrat dhe shkel standartet profesionale sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni është i Detyruar t'i dëmshperblejë shoqërise dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes ,si dhe t'i kalojë cdo përfitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga keto veprime të parregullta . Administratori ka barrën e proves për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyre të rregullt e sipas standardeve të

kërkura . Kur shkelja e kryer nga më shumë se një administrator , ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyre solidare .

- i) Në mënyrë të vecantë , por pa u kufuzuar për to , administratori është I detyruar t I dëmshperblejë shoqërisë demet e shkaktuara , nese , në , kundështim me dispozitat ligjore „Për Tregetarët dhe Shoqëritë Tregëtare , kryen veprimet e mëposhtëme:
- a) U kthen ortakeve kontributet :
 - b) U paguan ortakëve interesat apo dividente ;
 - c) U shpërndan aktivet shoqërisë;
 - d) Lejon që shoqëria të vazhdojë veprimitarinë tregëtare , kur , në bazë të gjëndjes financiare , duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
 - e) Jep kredi.

Neni 13

Viti Financiar

Viti Financiar i shoqerise fillon me 1 janar dhe perfundon ne 31 dhjetor. Perjashtimisht , viti I pare Financiar fillon nga data e regjistrimit te shkoqerisë ne QKB dhe mbylltet ne 31 dhjetor.

Neni 14

Bilanci i shoqërisë dhe dividentet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar , me vendim te Ortakeve, miratohet bilanci i paraqitur nga Administratori.

Ortaket vendosin rreth shpërndarjes së dividentit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar,sic parashikohet nga ligji.

Neni 15

Ekspertet

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimitarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë,atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tille i ngarkuar nga ana e asamblesë së ortakëve.

Ne përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të



ushtruara,të cilat është i detyruar që t ia paraqesë e dorëzojë në kohë asamblesë së ortakëve për ti shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Neni 16

Fitimet

Të ardhurat neto(dividenti) që mbeten pas veçimit të fondeve ligjore të mësipërme dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të tretëve,i mbeten dhe i kalojne në pronësi,ortakëve te shoqërisë.

Neni 17

Prishja e shoqërisë

Shpërnarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;
- b) me vendim të ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) nëse nuk ka kryer veprimitari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimitarisë në perputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723,datë 3.05.2007 “Për Qëndrën Kombëtare te Regjistrimit te Biznesit”;
- e) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast asambleja merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “Shoqëri në likuidim e sipër”.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjëndjen e aftësisë paguese,me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket themelues.

Nëse ortaket nuk marrin vendim për emërimin e likuiduesve,brenda 30 ditëve pas prishjes,çdo person i interesuar mund t i drejtohet gjykatës,për të caktuar një likuidues.

Neni 18

Likujdimi i shoqërise

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij. Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues,përveçse kur akti i emërimit pqrashikon se ata veprojnë veçmas njeri-tjetrit,likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të

posaçme. Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve,në peputhje me përcaktimet e ligjeve.

Likuiduesi i nënshtrohet mbikeqyrjes së ortakëve dhe administratorit.

Neni 19

Të drejtat e detyrimet e likuiduesit

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë,mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera,shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit,sipas nenit 605 të Kodit Civil.
2. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët ,sipas nenit 194 të ligjit “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”,likuiduesit vërejnë se pasuria shoqërisë tregtare ,përfshin detyrimin e pashlyera , nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve ,likuiduesit ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e fazës së falimentimit.

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjëndjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave.Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit,likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë.Bilancet kolektive dhe komanditë miratohen nga ortakët e tjerë,ndërsa në shoqëritë aksionare ata kanë përgjegjësi të kufizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme.

Neni 20

Perfundimi i likuidimit

Pas shperndarjes së aktiveve të mbetura,likuiduesi e njofton Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit te Biznesit për përfundimin e likuidimit dhe kérkon çregjistrimin e shoqërisë,në përputhje me sektionin nr.9723,datë 3.05.2007 “Për Qëndrën Kombetare të Regjistrimit te Biznesit”.

Neni 21

Bashkimi

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve dhe pasiveve të njërsës ose më shumë prej shoqërive që quhen shoqëri të perthitura ,të një shoqërie tjetër ekzistuese,e quajtur shoqëria përthithëse,në këmbim të aksioneve dhe kuotave të kësaj shoqërie.Ky proces quhet bashkim me perthithje.
2. Themelimit të një shoqërie të re,tek e cila kalon të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërise së re.Ky proces quhet bashkimi i një krijimi të një shoqërie të re.

Neni 22

Ndarja

1. Nje shoqëri mund të ndahet me vendim të Ortakëve,duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose më shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi.Shoqëria që ndahet vlerësohet e prishur.
2. Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatesisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të ligjit 9901 datë 14.04.2008..
3. Shoqëritë,që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet,quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet e kësaj të fundit.
4. Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qëndrës Kombëtare e Regjistrimit ka si pasoje kalimin te shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet ,në përputhje me raportin e ndarjes,të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes.Ky kalim sjell pasoja për marrëdhëniet ndërmjet shoqërite, si dhe për palët e treta;bërjen e aksionarëve/ortakëve të shoqërisë që ndahet aksione apo ortakë të një ose më shumë shoqërite pritëse,në përputhje me raportin e ndarjespërcaktonë marrëveshjen e ndarjes, vleresimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe rrëgjistrimin e saj nga Qendra Kombetare e Rregjistrimit, sipas seksionit V të ligjit nr . datë 3.05.2007 “Për Qëndrën Kombetare te Rregjistrimit” pa kryerjen e likujdimit .

Neni 23


Shndërrimi

Shoqëria mund te ndryshojë formen e vet ligjore , nepermjet shndërrimit të saj në shoqëri aksionere. Shoqëria nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet , që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të treteve .

Neni 24

Baza ligjore

Shoqëria do të zhvilloj aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë status dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar .



Për sa nuk parashikohet në këtë statut , do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për tregëtaret dhe shoqëritë tregëtare” Kodit Civil dhe çfardo ligjit tjeter specifik ne Republikën e Shqipërisë .

Neni 25

Mosmarrveshjet

Për mosmarrveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti ,si dhe për cdo mosmarrëveshje që mund të lindin midis Shoqërisë dhe të tretëve , do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare .

Neni 26

Dispozita përfundimtare

Ky Statut u redaktua ne 4 kopje me vlera të njëjta juridike në gjuhën shqipe dhe pasi u lexua nga ortaku , nënshkruhet me vullnet te lirë dhe të plotë .

ORTAKET

E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

GLOBAL GRAFIKA sh.p.k

Jonuz Myshketa

David Likmeta

David Likmeta

Jonuz Myshketa